



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Analizë e politikave:
Nr. 05/2018 - IKD

Ligji për Pagat në Sektorin Publik, paraqet ndërhyrje në drejtësi, krijon pasiguri juridike dhe krijon konglomerat në sistemin e pagave në sektorin publik

Prishtinë, tetor 2018

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ky raport nuk paraqet domosdoshmërisht qëndrimet e donatorit.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



British Embassy
Pristina



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Tetor 2018

Prishtinë, Republika e Kosovës

IKD: Ligji për Pagat në Sektorin Publik, paraqet ndërhyrje në drejtësi, krijon pasiguri juridike dhe krijon konglomerat në sistemin e pagave në sektorin publik

Prishtinë, 3 tetor 2018 - Pushteti ekzekutiv vazhdon qasjen diskriminuese në raport me pushtetin gjyqësor në Kosovë. Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Pagat në Sektorin Publik përmes të cilit ndërhyrje drejtpërdrejtë në pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe krijon pabarazi të pushteteve dhe pabarazi ndërmjet vet sistemit të drejtësisë, përkatësisht gjykatësve dhe prokurorëve.

Qeveria e Kosovës përmes këtij Projektligji të sponsorizuar nga Ministria e Administratës Publike përfundimisht dëshmon praktikën e mbrapshta të ekzekutivit, të cilat kanë synim të qartë, degradimin e pushtetit gjyqësor karrshi dy pushteteve tjera. Pushteti gjyqësor dhe prokurorial, sipas këtij projektligji, do të jenë të ranguar më poshtë sesa pushteti ekzekutiv dhe legjislativ. Për më tepër, në përmbajtje të tij, ky projekt ligj, krijon një konglomerat edhe më të madh në pagat e sektorit publik, duke ndërtuar një sistem të pagave, i cili nuk do të kompensohet në mënyrë ekuivalente, sipas meritës, ashtu siç e përcakton vetë qëllimi i këtij ligji.

IKD ka analizuar përmbajtjen e këtij ligji, me fokus në rregullimin e statusit të gjykatësve dhe prokurorëve. Praktikën dhe standardet ndërkombëtare për gjykatësit dhe prokurorët, ndalojnë lojën me sigurinë juridike të gjykatësve dhe prokurorëve, duke kërkuar në mënyrë eksplicite që pagat e tyre të rregullohen ekskluzivisht përmes ligjit dhe duke qenë ekuivalente me pushtetet e tjera. Por, projektligji për pagat në sektorin publik, sërish ul pagat e gjykatësve dhe prokurorëve, duke i bërë të pabarabartë me pushtetin ekzekutiv.

Pushtetet në Kosovë janë ekuivalente edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila garanton parimin e ndarjes së tyre. Parimi i ndarjes së pushteteve nënkupton edhe garantimin e ushtrimit të pushtetit në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje, dhe se kufizimi duhet të jetë i bazuar në balancimin e pushteteve vetëm në masën që e lejon Kushtetuta dhe kompetencat e secilit pushtet.

Loja me pushtetin gjyqësor dhe me pagat e gjykatësve dhe prokurorëve, ka një historik të gjatë, prej përfundimit të luftës në Kosovë. Ekzekutivi vazhdimisht ka krijuar varshmëri të gjykatësve dhe prokurorëve ndaj ekzekutivit, të cilët janë ndikuar në masë të madhe nga politika. Kjo e fundit, përmes Kuvendit të Kosovës në vitin 2010, kishte miratuar Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit, duke ndërtuar standardin e nivelizimit të pagave për gjykatës dhe prokurorë me pagat në ekzekutivin e vendit, respektivisht pagat e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit ishin barazuar me pagën e Kryeministrit të vendit, përderisa pagat e prokurorëve dhe gjykatësve ishin nivelizuar me pagat e ministrave në qeveri. Kjo është hera e parë që është krijuar një ekuivalencë në pagat bazë në mes të pushtetit ekzekutiv dhe pushtetit gjyqësor.

IKD e cila monitoron sistematikisht sistemin e drejtësisë, por edhe organizata tjera vendore dhe ndërkombëtare si Raporti i Progresit të Komisionit Evropian dhe Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit kanë ngritur shqetësimet për ndikimin politik në sistemin e drejtësisë.

Si rezultat i këtyre ndikimeve politike në pushtetin gjyqësor dhe prokurorial, nuk ka pasur as reagim nga përfaqësuesit e këtyre pushteteve, në dhjetor të vitit 2017, kur Qeveria e Kosovës në mënyrë të kundërligjshme përmes vendimit ka ngritur pagat për vete, rrjedhimisht edhe për gjykatësit dhe prokurorët.

Për dallim prej pushtetit gjyqësor e prokurorial, të cilët kanë qenë përfitues të rritjes së pagave, IKD ka reaguar publikisht ndaj Vendimit Nr. 4/20, të Qeverisë Haradinaj të miratuar më 20 dhjetor 2017 për rritjen e pagave të pushtetarëve, gjykatësve dhe prokurorëve. Ndaj këtij vendimi kanë reaguar edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë dhe organizatat tjera.

Përmes këtij vendimi, pothuajse janë dyfishuar pagat e pozitive të lartë-përmendura. Paga e Kryeministrit të Kosovës, është ngritur në 2950 euro, përderisa paga e Zëvendëskryeministrave është ngritur në 2500 euro. Pagat e Ministrave me këtë vendim janë ngritur në 2000 euro. Po ashtu pagat e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit, ishin ngritur në 2950.

Vendimi i Qeverisë, sipas analizës ligjore të IKD-së, kishte tejkaluar kompetencat e përcaktuara me Ligj dhe me Rregulloren e Punës së Qeverisë, e cila në asnjë dispozitë të saj nuk përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Qeverisë për caktimin e pagave apo kompensimit për Kryeministrin apo ministrat. Në bazë të Kushtetutës dhe ligjit të aplikueshëm në Kosovë, kompetentë për të vendosur lidhur me pagat e funksionarëve të lartë publik në Kosovë, veçanërisht për pozitën e Kryeministrit dhe ministrave është Kuvendi i Kosovës. Prandaj, ky vendim nga IKD është konsideruar i kundërligjshëm dhe ndërhyrje arbitrare e drejtpërdrejtë në kompetencat e Kuvendit të Kosovës. Vendimi i miratuar nga Qeveria Haradinaj, përveç që është bërë në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, i njëjti është bërë pa analizë ligjore adekuate dhe pa vlerësim apo konsultim lidhur me ndikimin financiar që ky vendim ngërthen në vete për buxhetin e pushtetit ekzekutiv dhe pushtetin gjyqësor.

Edhe pse ky vendim ka qenë i kundërligjshëm, nuk ka pasur asnjë reagim nga organi ndjekës – Prokurori i Shtetit. Ndryshe prej Prokurorit të Shtetit, ka pasur një reagim nga Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK). Vendimi lidhur me ngritjen e pagave bie në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës, respektivisht nenin 424, i cili përcakton situatat e konfliktit të interesit në rastet kur zyrtarët e lartë shtetërorë marrin pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare në të cilën ai apo ndonjë anëtar i familjes ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të ka interes financiar. Për këtë gjendje të konfliktit të interesit, ka zbatuar mandatin edhe AKK, e cila ka njoftuar Qeverinë se vendimi për pagat paraqet konflikt të interesit dhe se i njëjti nuk mund të zbatohet, ndryshe kjo përbën vepër penale. Tash për tash, AKK është duke hetuar rastin e konfliktit të interesit për pagat, ndërsa për të njëjtin vendim Lëvizja Vetëvendosje ka ngritur një kallëzim penal, i cili ende po sillet nëpër Prokurori dhe nuk po trajtohet.

Përfundimisht, përderisa nuk ndryshon mendësia e pushtetit ekzekutiv, i cili përmes vendimeve të kundërligjshme krijon privilegje për pushtetarët dhe krijon pasiguri juridike në sistemin e pagave

në sektorin publik, sidomos tek gjykatësit dhe prokurorët, dëshmon që logjika e instaluar ndërhyrjes dhe degradimit mbi pushtetin gjyqësor është duke vazhduar.

Prandaj, IKD kërkon që të finalizohet sa më parë Projektligji për Pagat në Sektorin Publik, në të cilin do duhej të rregullohej konglomerati me pagat në të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtij ligji, duhet të rregullohet edhe çështja e pagave të bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale, i cili duhet të bëhet në mënyrë meritore, bazuar në parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për barazinë e pushteteve.

Projekt-Ligji për Pagat në Sektorin Publik

Qeveria e Kosovës më 3 shtator 2018, kishte miratuar vendimin Nr. 08/63 lidhur me Projekt Ligjin për Pagat në Sektorin Publik. Ky ligj përcakton sistemin e pagave dhe shpërblimeve për zyrtarët dhe funksionarët publikë, që paguhen nga buxheti i shtetit, dhe rregullat për përcaktimin e pagave të punonjësve të ndërmarrjeve publike në Kosovë.

Projekt ligji në fjalë kishte përcaktuar parimet mbi të cilat do të bazohen pagat në sektorin publik, të cilat janë:

- a) Parimi i ligjshmërisë që pagat e përfituesve përcaktohen vetëm në pajtim me këtë ligj dhe me aktet nënligjore, të autorizuar dhe të nxjerra në zbatim të tij.
- b) Parimi i drejtësisë që niveli i pagës duhet të shpërblejë në mënyrë të drejtë kompleksin e punës dhe kontributin e individit në punën e organizatës.
- c) Parimi i pagës së barabartë që secili përfitues i pagës merr pagë të barabartë për punën në funksionin, pozitën apo gradën e njëjtë apo të krahasueshme.
- d) Parimi i transparencës që procedura për përcaktimin e pagës, niveli i saj dhe administrimi i sistemit të pagave të jetë transparente për publikun, pa rënë në kundërshtim me mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi.
- e) Parimi i mosdiskriminimit që asnjë përfitues i pagës nuk diskriminohet në pagë, ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, etj.

Projekt ligji i miratuar nga Qeveria Haradinaj shkelë rëndë parimin e ndërtuar nga ish-qeveritë e mëhershme lidhur me nivelizimin dhe barazimin e pagave të ekzekutivit më pushtetin gjyqësor. Ashtu edhe si është përshkruar në tabelën më poshtë nr. 1, përderisa paga e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit, sipas Ligjit për Gjykatat dhe Ligjit për Prokurorin e Shtetit ishte e nivelizuar me pagën e Kryeministrit të Kosovës, në shumën prej 1443 euro bruto. Edhe sipas vendimit të Qeverisë Haradinaj për ngritje të pagave, pagat e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit ishin në nivel të njëjtë me pagën e Kryeministrit Haradinaj, në shumën prej 2950 euro bruto.

Përderisa, me projekt ligjin për Pagat në Sektorin Publik, paga e Kryeministrit të Kosovës, është një koeficient më e lartë se paga e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit.

Paga e Kryeministrit me këtë projekt ligj ka koeficientin¹ 11, në lartësi prej 2629 Euro, përderisa pagat e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit janë ulur në koeficient 10, respektivisht në shumën prej 2390 euro, apo 239 euro paga e tyre do të jetë më e vogël se paga e Kryeministrit.

Neni 27 i Projekt Ligjit në dispozitat transitorë ka përcaktuar se nëse një individ, zyrtar apo funksionar publik, përfitonte përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, një pagë të plotë (paga bazë me të gjitha llojet e shtesave të rregullta), që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe një shtesë transitorë të posaçme të barabartë me diferencën ndërmjet pagës së vjetër dhe pagës së re.

Sipas këtij neni, individi, zyrtari apo funksionari publik, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, do të përfitojë pagën e re në:

- a) 100% të shtesës transitorë të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- b) 75 % të shtesës transitorë të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- c) 50 % të shtesës transitorë të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- d) 25 % të shtesës transitorë të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 3. Funksionarët dhe zyrtarët publikë të angazhuar/rekrutuar pas miratimit të këtij ligji përfitojnë pagën sipas këtij ligji.

Përmes kësaj dispozite të projekt ligjit, Qeveria ka bërë përpjekje që pagat e zyrtarëve të mos i ulë vetëm në vitin e parë, përkatësisht duke ua mundësuar marrjen e shtesave transitorë, të cilat do të siguronin që funksionarët dhe zyrtarët të marrin pagat në lartësi të njëjtë, sikurse para hyrjes eventuale të këtij ligji në fuqi. Përderisa, i njëjti ligj përcakton se shtesat transitorë do të ndryshojnë nga viti në vit, duke filluar prej vitit të dytë, në të cilin do të ulet në 75%, në vitin e tretë 50% dhe në vitin e katër 25%. Rrjedhimisht, kjo nënkupton se gjykatësit dhe prokurorët, në rast të hyrjes në fuqi të këtij ligji, vetëm në vitin e parë, do të merrnin pagat pa zbritje, ndërsa më pas, çdo vit, do të marrin paga me ulje.

IKD në vazhdimësi ka kërkuar nga ekzekutivi dhe legjislativi të ruajnë dhe respektojnë pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, gjatë hartimit të politikave që ndërlidhen me pushtetin gjyqësor duhet të sigurohen që të zbatojnë standarde dhe praktika ndërkombëtare që promovojnë pavarësinë dhe integritetin e pushtetit gjyqësor.

Në këtë drejtim, IKD përmes kësaj analizë ua ri kujton pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ në Kosovë, se Komisioni i Venecias ndan mendimin se pagat për gjykatës duhet të korrespondojnë më dinjitetin e profesionit të gjykatësit dhe se paga adekuate është e një rëndësie të veçantë për të mbrojtur gjykatësin nga ndikimi i jashtëm. Niveli i pagës duhet të vendoset në bazë të kushteve

¹ Sipas nenit 22 paragrafi 1 i Projekt Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, një koeficient është përcaktuar në vlerën prej 239 Euro. Shih vegzën: <http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/09/PROJEKTLIGJI-P%C3%8BR-PAGAT-N%C3%8B-SEKTORIN-PUBLIK.pdf>

sociale, duke krahasuar nivelin e pagave të zyrtarëve më të lartë. Caktimi i pagës duhet të bazohet në një standard të përgjithshëm dhe të përcaktohet në kritere objektive dhe transparente.

| Pozita: | Paga vendimit muajit 2017 | para të dhjetor | Paga vendimit Qeverisë ngritjen e pagave | sipas të për | Pagat sipas Projekt Ligjit për Pagat | Dallimi |
|------------------------------------|----------------------------------|------------------------|---|---------------------|---|----------------|
| Kryeministri | 1443 | | 2950 | | 2629 | 321 |
| Kryetari i Gjykatës Supreme | 1443 | | 2950 | | 2390 | 560 |
| Kryeprokurori i Shtetit | 1443 | | 2950 | | 2390 | 560 |

Karakteristikë e këtij projekt ligj për paga është se edhe përkundër faktit se ka përcaktuar parimin e pagës së barabartë që secili përfitues i pagës merr pagë të barabartë për punën në funksionin, pozitën apo gradën e njëjtë apo të krahasueshme, i njëjti parim shkelet gjatë përcaktimit të koeficienteve për prokuror dhe gjykatës të të njejtave nivele.

Me projekt ligjin në fjalë, paga e prokurorit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit ka koeficient 9, apo pagë mujore prej 2151 Euro, kurse paga e gjykatësit në Gjykatën Supreme ka koeficient 8.5 apo pagë mujore prej 2031 Euro. Një qasje e tillë e vë në pozitë të pabarabartë dhe degradon pozitën e gjykatësit në Gjykatën Supreme në raport me pozitën e prokurorit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Edhe përkundër faktit se Ligji për Gjykatat dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit ka përcaktuar strukturën ekuivalente të gjykatave dhe prokurorive, ato përmes këtij projekt ligji vihen në situatë të pabarabartë, duke përlulur gjyqësorin karshi prokurorisë.

Qasje të njejtë, ky projekt ligj ka edhe në raport me pozitën tjera në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Përderisa, me këtë projekt ligji paga e Kryeprokurorit të Apelit është përcaktuar në shumën prej 2151 euro, paga e Kryetarit të Gjykatës së Apelit është përcaktuar në shumën prej 2031 euro. Dallim në pagë, është edhe në raport me gjykatësit dhe prokurorët në gjykatën e apelit dhe prokurorinë e apelit. Prokurorët në apel sipas këtij projekt ligji do të kenë 1912 euro, kurse gjykatësit 1553 euro, apo diferencë prej 359 euro.

Edhe paga e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore do të jetë më e lartë se Kryetari i Gjykatës Themelore. Kryeprokurorët e prokurorive themelore do kenë pagën në vlerë prej 1912 euro, kurse Kryetarët e gjykatave themelore do kenë pagën prej 1553 euro, apo pagë më të ultë në shumën prej 359 euro.

| Pozita | Paga vendimit muajit 2017 | para të dhjetor | Paga vendimit Qeverisë ngritjen e pagave | sipas të për e | Pagat sipas Projekt Ligjit për Pagat | Dallimi |
|---------------|----------------------------------|------------------------|---|-----------------------|---|----------------|
|---------------|----------------------------------|------------------------|---|-----------------------|---|----------------|

| | | | | | |
|---|----|------|------|------|-----|
| Gjykatësi në Gjykatën Supreme | në | 1299 | 2655 | 2031 | 624 |
| Prokurori Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit | në | 1299 | 2655 | 2151 | 504 |
| Kryeprokurori PSRK | i | 1377 | 2802 | 2270 | 532 |
| Prokurori PSRK | në | 1305 | 2655 | 2151 | 504 |
| Kryetari Gjykatës së Apelit | i | 1299 | 2655 | 2031 | 624 |
| Kryeprokurori Prokurorisë së Apelit | i | 1299 | 2655 | 2151 | 504 |
| Gjykatësi në Apel | në | 1170 | 2389 | 1553 | 836 |
| Prokurori në Apel | në | 1170 | 2389 | 1912 | 477 |
| Kryetari Gjykatës Themelore | i | 1174 | 2389 | 1553 | 836 |
| Kryeprokurori Prokurorisë Themelore | i | 1174 | 2389 | 1912 | 477 |

| | | | | | |
|--------------------------------------|-----|------|------|------|-----|
| Pozita | | | | | |
| Gjykatës mbikqyrës | | 1115 | 2269 | 1434 | 835 |
| Gjykatës për Krime të Rënda në GjTh | | 1057 | 2150 | 1434 | 716 |
| Prokuror për Krime të Rënda në PTh | | 1057 | 2150 | 1434 | 716 |
| Gjykatës Departament të Përgjithshëm | në | 821 | 1672 | 1314 | 358 |
| Prokuror Departament të Përgjithshëm | në | 921 | 1672 | 1314 | 358 |
| Gjykatës kundërvajtje | për | 821 | 1672 | 1195 | 477 |

IKD vlerëson se pagat e gjykatësve dhe prokurorëve nuk mund të ndryshohen në radhë të parë përmes vendimeve të Qeverisë si ka qenë rasti me vendimin e miratuar nga Qeveria Haradinaj në dhjetor të vitit 2017, si dhe nuk mundet që pagat e gjykatësve dhe prokurorëve të zvoglohen qofte edhe me ligj. Një qasje e tillë e cenon rëndë sigurinë juridike dhe financiare të gjykatësve dhe prokurorëve, dhe hyn në kuadër të ndërhyrjeve të drejtëpërdrejta të pushtetit ekzekutiv apo legjislativ në pushtetin gjyqësor.

Për më tepër, për herë të parë, përmes këtij projekt ligji aplikohen standarde të ndryshme lidhur me lartësinë e pagave për gjykatës dhe prokuror. Qeveria përmes kësaj, kanë paraparë paga më të larta për prokuror në raport me gjykatësin, duke degraduar profesionin e gjykatësit në raport me prokurorin.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton parimin e ndarjës së pushteteve. Parimi i ndarjes së pushteteve nënkupton edhe garantimin e ushtrimit të pushtetit në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje, dhe se kufizimi duhet të jetë i bazuar në balancimin e pushteteve vetëm në masën që e lejon Kushtetuta dhe kompetencat e secilit pushtet. Projektligji për Pagat në Sektorin Publik, dhe ulja e pagave për gjykatës dhe prokuror, cenon rëndë parimin e ndarjes së pushteteve.

Qëndrim pothuajse të njëjtë lidhur me pagat e gjykatësve mban edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara në komentin nr. 32, që ndërlidhet me zbatimin e nenit 14 të Konventës për të drejtat politike dhe civile e aplikueshme drejtpërdrejtë në Kosovë. Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës mban qëndrim të njëjtë përmes rekomandimit nr. R(94) 12, Parimi III, para, 1b. Po ashtu neni 13 i Kartës Universale të Gjykatësve përcaton se gjykatësit duhet të pranojnë pagesë të mjaftueshme për të siguruar pavarësi të vërtetë ekonomike. Paga nuk duhet të bazohet në rezultate të gjykatësit, dhe nuk guxon të zvogëlohet gjatë shërbimit të tij. Përderisa, mbrojtja e pavarësisë së gjykatësve është e garantuar edhe me Kushtetutë, siç është rasti i nenit 3, seksionit të Kushtetutës së SHBA-ve që përmban ndalesë të drejtpërdrejtë për zvoglimin e pagesës së gjykatësit gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

Kjo formë krijon drejtpërdrejtë pasiguri juridike për pagat e gjykatësve dhe prokurorëve, ndikim dhe cenim të pavarësisë së tyre në ushtrimin e pavarur, të paanshëm dhe në mënyrë profesionale të funksionit të tyre.

Shqetësim tjetër në projektligjin për Pagat në sektorin publik, është edhe pabarazia që vendoset në mes të gjykatësve dhe prokurorëve të të njëjtit nivel. Në të gjitha vendet demokratike, shtetet që kanë krijuar legjislacionin që rregullon fushën e sistemit të drejtësisë, bazuar edhe në standardet ndërkombëtare, gjykatësit dhe prokurorët e të njëjtit nivel i trajtojnë në mënyrë të barabartë. Prandaj, IKD konsideron se përmes këtij projekt ligji, krijohet pabarazi dhe diskriminim i gjykatësve në raport me prokurorët.

IKD përfundimisht i bën thirrje Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës që të trajtojë seriozisht barazinë e pushtetit gjyqësor me vetën e tyre, njëjtë sikurse garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim, kërkon që të finalizohet sa më parë Projektligji për Pagat në Sektorin Publik, në të cilin do duhej të rregullohej konglomerati me pagat në të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtij ligji, duhet të rregullohet edhe çështja e pagave të bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale, i cili duhet të bëhet në mënyrë meritore, bazuar në parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për barazinë e pushteteve.